



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008),nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës, nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës nr.-I-12851, të dt.17.05.2022, në mbledhjen e mbajtur me dt.26.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Sami Saraqit, Kryetar i Shoqatës së invalidëve të UÇK-së-dega në Obiliq për mbështetje financiare për 53 invalidë për pushime verore në Shqipëri.
2. Shuma e mjeteve të ndara sipas pikës 1 të këtij vendimi është 7,950.00 €, mjetët e ndara do të sigurohen nga kategoria e subvencioneve të DSHPE-së.
3. Qëllimi i këtij vendimi është përkrahja financiare e 53 invalidëve të UÇK-së, të Komunës së Obiliqit, për pushime verore në Shqipëri sipas rekomandimit dhe paralogarisë së DSHPE-së: 30 € nata për person, për 5 netë ($30 \times 5 = 150$), totali për 53 persona ($150 \times 53 = 7,950.00$ €).
4. Obligohet DSHPE-ja të kompletoj dokumentacionin e nevojshëm për 53 invalidët e UÇK-së, të Komunës së Obiliqit, ndërsa DEFZH-ja të zbatoj këtë vendim.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T' idërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- MAPL
- DSHPE
- Anëtarëve të KK
- Arkivit

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi

